



SHOQATA KOMBETARE E TRANSPORTIT QYTETAS

Datë, 09/06/2026

KËRKESE

Kërkues: Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas, me nipt K42407012T, me adresë Rruga “Llazi Miho” Nd. 6, Sh. 1, Kat 1, Kombinat, Tiranë.

Të dhënat elektronike të kontaktit (neni 154/2/a i KPC) Tel: **068 4030111**

LËNDA: Kërkesë për marrjen në konsideratë të kilometrave të perealizuara për shkak të devijimeve dhe bllokimeve të akseve rrugore gjatë protestave.

DREJTUAR: BASHKISË TIRANË

Kryetar

Zj. Anuela RISTANI

BASHKISË TIRANË

Drejtor I Përgjithshëm I Punëve Publike

Drejtorisë së Transportit dhe Trafikut Rrugor

Z. Enton PUNAVIJA

Të nderuar,

Shoqata e Transportit Publik Qytetas dëshiron të sjellë në vëmendjen tuaj situatën e krijuar gjatë javës së fundit dhe në vijim, si pasojë e protestave të zhvilluara në territorin e Bashkisë Tiranë, të cilat kanë sjellë bllokime dhe devijime të vazhdueshme të akseve kryesore rrugore. Për shkak të këtyre kufizimeve të qarkullimit, operatorët e transportit publik qytetas janë detyruar të ndryshojnë itineraret e linjave, të devijojnë nga rrugët e miratuara dhe në shumë raste të mos kenë mundësi të realizojnë plotësisht kilometrat e planifikuara sipas kontratave dhe detyrimeve të përcaktuara nga Bashkia Tiranë. Theksojmë se kjo situatë nuk ka ardhur si pasojë e neglizhencës apo mosangazhimit të operatorëve, por për shkak të rrethanave objektive dhe të pavarura nga vullneti i tyre. Pavarësisht vështirësive, operatorët kanë vijuar të ofrojnë shërbimin e transportit publik në masën më të madhe të mundshme, duke garantuar lëvizjen e qytetarëve dhe funksionimin e rrjetit të transportit.



SHOQATA KOMBËTARE E TRANSPORTIT QYTETAS

Kështu, kërkojmë që në vlerësimin e performancës së operatorëve për periudhën e javës së kaluar dhe ditët në vijim, të merren në konsideratë kushtet e jashtëzakonshme të krijuara nga protestat, devijimet dhe bllokimet e akseve rrugore. Konkretisht, kërkojmë që kilometrat e porealizuara si pasojë e këtyre rrethanave të njihen dhe të konsiderohen si kilometra të realizuara për efekt të vlerësimit të performancës dhe detyrimeve kontraktore të operatorëve.

Jemi të bindur se Bashkia Tiranë do të vlerësojë me objektivitet këtë situatë të jashtëzakonshme dhe do të marrë në konsideratë ndikimin real që ajo ka pasur në aktivitetin e operatorëve të transportit publik qytetas.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin, mbetemi në pritje të shqyrtimit të kërkesës sonë.

Me respekt,

Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas

**KRYETAR
Kostandin Foni**

Kostandin Foni



Kostandin Foni